



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/212
Datë: 10.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 30 paragrafit 2. të Ligjit Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore, nenit 12 të Ligjit Nr. 08/L-137 për Pyjet, në përputhje me Vendimin e Qeverisë Nr. 06/134 të datës 1 mars 2017, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 06/121 të datës 25 janar 2023

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1. e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 06/121 të datës 25 janar 2023, dhe shtohet nën-paragraf 1.1 si në vijim:
 - 1.1. Ministrisë së Ekonomisë i zgjatet afati për periudhë shtesë prej katër (4) viteve i së drejtës së shfrytëzimit të pronave nga Shtojca 1. e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.06/121 të datës 25 janar 2023. Kjo periudhë është e nevojshme për mbulimin e periudhës së kaluar në procesin e ofertimit konkurrues dhe periudhën për ndërtimin e parkut solar 100 MW.
2. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përkatësisht Agjencia e Pyjeve të Kosovës, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, përkatësisht Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m


Qeveria e Republikës së Kosovës me datë 25 janar 2023 ka marrë vendim (Vendimi Nr. 06/121) që nëntë (9) parcela pronë publike që ndodhen në Komunën e Rahovecit (Zona Kadastrale Kramovik dhe Petroviç) të barten tek Ministria e Ekonomisë me të drejtë të shfrytëzimit për një periudhë tridhjetë (30) vjeçare. Bartja e të drejtës së shfrytëzimit tek Ministria e Ekonomisë është bërë me qëllim që Ministria e Ekonomisë të jap me qira pronën publike në shfrytëzim te investitori i përzgjedhur si ofertuesi më i favorshëm për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese bazuar në burime të ripërtërishme përmes një procesi të hapur konkurrues-ankand.

Ministria e Ekonomisë ka shpallur shprehjen e interesit për procesin e ofertimit konkurrues-ankandit me datë 12 maj 2023, me datë 13 mars 2023 Ministrisë së Ekonomisë i regjistrohet e drejta e shfrytëzimit të pronës publike nga zyra kadastrale në Komunën e Rahovecit, dhe me datë 16 prill 2024 Ministria e Ekonomisë ka përzgjedhur ofertuesin më të favorshëm nga procesi i ofertimit konkurrues. Me datë 31 maj 2024 Ministria e Ekonomisë ka nënshkruar marrëveshjen për zhvillim të projektit me ofertuesin më të favorshëm për ndërtim të parkut solar me një kapacitet prej 100 MW.

Periudha shtesë prej katër (4) viteve jepet me qëllim për të mbuluar kohën e shpenzuar gjatë procesit të ofertimit konkurrues deri në përzgjedhjen e ofertuesit më të favorshëm, duke përfshirë edhe periudhën e nevojshme për ndërtim të parkut solar 100 MW pas përzgjedhjes së ofertuesin më të favorshëm.

Sa për më lartë, ofertuesi më i favorshëm, përkatësisht ofertuesi fitues me çmimin më të ulët të ofruar gjatë procesit të ofertimit konkurrues fiton të drejtën e shfrytëzimit të parcelave nga Aneksi 1 i Vendimit Nr. 06/121 për ndërtim të parkut solar 100 MW nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Qirasë (31 maj 2024). Ofertuesi fitues paguan qira gjatë periudhës së ndërtimit dhe gjatë periudhës tridhjetë (30) vjeçare të operimit, për çka edhe bëhet përshtatja e afatit fillestar.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë